



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1022/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Afijete Sada Glllogjani, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Shqipe Fejza nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1022/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Shqipe Fejza nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakovës paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilën ka kërkuar Rinumërimin e votave në Qendrën e votimit 0203C/05D, 0208C.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1022/2021, i ushtruar nga Shqipe Fejza Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se në vendvotimet 0203C/05D, 0208C, ku kanë votuar të afërmit nga kjo del se ka mos përputhje të rezultateve nga pritshmëria për të më votuar ka qenë ma e madhe se rezultatit i cili ka dal nga KQZ.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezultojnë fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, Shqipe Fejza, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet 0203C/05D, 0208C, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Shqipe Fejza Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, më të cilin apel kërkon që ti korrigjohen votat është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, i njëjti nuk ka ofruar asnjë dëshmi qoftë formular apo deklaratë, që dëshmojnë ato pretendime të cilat pretendon se nuk i kanë dalë votat, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se ka mungesë të votave në vendvotimet 0203C/05D, 0208C, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.1022/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit**  
**Zyheri Haziri**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.